



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

<b>Datë/a:</b>	16.07.2021
<b>Referenc-ë:</b>	07-353/04-13695/21
<b>Për/ Za/ To:</b>	OJQ “Syri i Vizionit”
<b>Përmes/Preko/Through:</b>	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-13695/21 nga OJQ “Syri i Vizionit” me përfaqësues Naser Lajqi me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi, “Skënderbeu” me datë 17, 18 dhe 19 Korrik 2021.

Qëllimi i kërkesës është shënimi i një (1) vjetorit të hyrjes në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Ky aktivitet do të realizohet me moton “Rripi nuk është për me m`rreh”, ku do të vendoset një rripë me gjatësi 5 metra dhe gjerësi 0.5 metra ku qytetarët do të kenë mundësi të shkruajnë mesazhe vetëdijësuese për prindërit që ndalohet dhuna dhe ndëshkimi trupor ndaj fëmijëve. Ky instalacion do të qëndroj në shesh nga data 17 Korrik 2021 deri më 19 Korrik 2021.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin OJQ “Syri i Vizionit” për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Skënderbeu” me datë 17, 18 dhe 19 Korrik 2021 me qëllim që të rritet vetëdija e shoqërisë në parandalimin e dhunës dhe ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve. Instalacioni do të qëndroj në shesh nga data 17 deri me datë 19 Korrik 2021.

**Kushtet e pëlqimit:**

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;

- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;

- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.